



FEDERATA E SHENJËTARISË SPORTIVE E KOSOVËS  
SPORTSKA STRELJAČKA FEDERACIJA KOSOVA  
KOSOVO SHOOTING SPORT FEDERATION  
Adresa: Rr. "Agim Ramadani" Nr. 43. Shtëpia e Sporteve Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0) 38 244 473  
e-mail: [info@fshsk.org](mailto:info@fshsk.org), [gezim.hazrolli@fshsk.org](mailto:gezim.hazrolli@fshsk.org)

---

---

## RREGULLORJA

**mbi mënyrën dhe kriteret e përzgjedhjes së Laureatëve të vitit të  
FSHSK-së**

Prishtinë, 11.11.2022

Në bazë të nenit 22. Alinea 2.21 të Statutit të FSHSK-së, Këshilli drejtues në mbledhjen e vetë tëmbajtur më 11.11.2022 miratoi:

## RREGULLORËN

### MBI MËNYRËN DHE KRITERET E ZGJEDHJES SË SHENJËTARIT-ËS, TRAJNERIT, REFERIT, KLUBIT DHE PUNËTORIT TË VITIT

#### I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

##### Neni 1

- 1.1 Me këtë Rregullore caktohet mënyra dhe kriteret për zgjedhjen e shenjëtarit-ës , trajnerit, referit, klubit dhe punëtorit më të mire të vitit në Republikën e Kosovës..
- 1.2 Propozimin për zgjedhjen e shenjëtarit-ës, trajnerit, referit, klubit dhe punëtorit të shenjëtarisë në Republikën e Kosovës e përgatitë Komisioni Professional bashkë me Komisionin e referëve dhe ia drejton Këshillit drejtues për aprovim.
  - 1.2.1 Këshilli drejtues mund të aprovoi si në propozim nëse janë respektuar mënyra dhe kriteret e përcaktuara në pikat 3.1 deri 8.1.8 të kësaj Rregulloreje, në të kundërtën atë mund ta ndryshoi dhe plotësoi në përputhje me këtë Rregullore.
- 1.3 Zgjedhja e shenjëtarit dhe shenjëtares më të mire të Kosovës bëhet ndaras.
- 1.4 Nëse numri i propozuar për zgjedhjen e shenjëtarit – shenjëtares është i njëjtë, atëherë përparësi i epet shenjëtares.
- 1.5 Raporti në gjini me rastin e zgjedhjes së 10 më të mirëve nuk mund të jenë më e madhe se 3:2 në favor të meshkujve.
  - 1.5.1 Raporti në mes të kategorisë së seniorëve dhe juniorëve, varet nga rezultatet e arritura të moshës së juniorëve në kategorinë e seniorëve.
- 1.6 Kategoria e pionierëve dhe pioniereve bënë pjesë në zgjedhjen e shpresave të sportistëve shenjëtarisë.
- 1.7 Zgjedhja e shpresave bëhet në disiplinat në gjuajtje me pushkë ajrore, serike, kurse e më të mirëve të vitit bëhet në gjuajtje me pushkë dhe pistoletë ajrore standarde, standarde, pushkë dhe pistoletë të KV në 25 m dhe 50 m.
- 1.8 Kategori e veçantë është zgjedhja e sportistit më të mire me nevoja të veçanta.

- 1.9 Kandidatët që konkurrojnë në grupmoshën e juniorëve, duhet të paraqesin dëshmi:Për moshën - letërnjoftim ose certifikatën e lindjes.

## II. MËNYRA E ZGJEDHJES

### Neni 2

- 2.1 Të gjitha klubet e shenjëtarisë në Republikë, anëtar të FSHSK-së, janë të obliguara që të bëjnë zgjedhjen e shenjëtarit-ës, trajnerit, referit, klubit dhe punëtorit më të mirë për vitin që po kalon dhe në afatin e caktuar ia dorëzojnë Shërbimit profesional të FSHSK-së.
- 2.2 Shërbimi Profesional i FSHSK-së në marrëveshje me Kryetarët e Komisionit profesional dhe Komisionit të referëve, do të caktojë mbledhjen për shqyrtimin e propozimeve të klubeve dhe caktimin e listës për zgjedhjen e listës nga pika 1.1 të kësaj Rregulloreje.
- 2.3 Përpilimin e listës së më të mirëve, komisionet do ta bëjnë në bazë të propozimeve të klubeve dhe njohurive të veta, duke respektuar kriteret e caktuara më këtë Rregullore.
- 2.4 Radhitja e më të mirëve e përpiluar sipas pikës 2.2 i dërgohet për shqyrtim dhe aprovim Këshillit drejtues të FSHSK-së.
- 2.5 Këshilli drejtues ka të drejtë që listën e radhitjes së më të mirëve nga ana e komisioneve, të aprovoi, të ndryshojë ose të plotësoi në pajtim me Rregulloren në fjalë.
- 2.6 Vendimi i Këshillit drejtues për caktimin e listës së më të mirëve nga pika 1.1 është definitive.

## III. KRITERET PËR ZGJEDHJEN E MË TË MIRËVE TË VITIT

### Neni 3

- 3.1 Kriteret e zgjedhjes së më të mirëve nga pika 1.1 caktohen ndaras për:
- 3.1.1 - shenjëtar-re,
  - 3.1.2 - trajner,
  - 3.1.3 - refer,
  - 3.1.4 - klub, dhe
  - 3.1.5 - punëtor.

## **A. Kriteret për zgjedhjen e shenjëtarit-ës më të mire të vitit**

### Neni 4

- 4.1 Kriteret për zgjedhjen e shenjëtarit-ës më të mire të vitit janë:
- 4.1.1 Plasmani në Kampionatin e Republikës në vendin: I : II : III – 5 : 3 : 1, poena,
  - 4.1.2 Plasmani në Kupat e organizuara nga FSHK-ja: I : II : III – 3 : 2 : 1, poena,
  - 4.1.3 Plasmani në garat ndërkombëtare në vendet: I : II : III – 6 : 4 : 2, poena,
  - 4.1.4 Për pjesëmarrje në garat ndërkombëtare: 4 poena.

## **B. Kriteret për zgjedhjen e trajnerit të vitit**

### Neni 5

- 5.1 Kriteret për zgjedhjen e trajnerit më të mire të vitit janë:
- 5.1.1 Puna sistematike në ushtrimet e garueseve: 30, poena,
  - 5.1.2 Plasmani ekipor në Kampionatin e Republikës: I : II : III – 3 : 2 : 1, poena,
  - 5.1.3 Plasmani individual në Kampionatin e Republikës: I : II : III – 3 : 2 : 1, poena,
  - 5.1.4 Plasmani individual në Kupa: I : II : III – 15 : 10 : 5, poena,
  - 5.1.5 Për pjesëmarrje të garuesve në garat ndërkombëtare: 1 poena për çdo garues,
  - 5.1.6 Për plasman të garuesit në gara ndërkombëtare në vendët: I deri III, 5 poena,
  - 5.1.7 Për masovizim të klubit të dy gjinive: 3 poena.
  - 5.1.8

## **C. Kriteret për zgjedhjen e referit të vitit**

### Neni 6

- 6.1 Kriteret për zgjedhjen e referit më të mire të vitit janë:
- 6.1.1 Respektimi i Rregulloreve të garave: 2 poena,
  - 6.1.2 Referimi pa gabime: 2 poena,
  - 6.1.3 Pjesëmarrja e rregullt në referime: 2 poena,

#### Poena negative

- 6.1.4 Nëse gjatë referimit e lëshon ose e kundërshton detyrën: -5 poena,
- 6.1.5 Nëse pranon por nuk e konfirmon mosardhjen në referim: -4 poena,
- 6.1.6 Nëse gjatë referimit I kundërshton urdhëratë e referit kryesor: -5 poena,
- 6.1.7 Nëse gjatë kryerjes së detyrës favorizon ose dëmton garuesin: -5 poena,
- 6.1.8 Për gabimet nga pika 6.1.5 deri në pikën 6.1.7, dënohet me ndalesë të referimit në 4 (katër) garat e radhës.

#### **D. Kriteret për zgjedhjen e klubit të vitit**

##### Neni 7

- 7.1 Kriteret për zgjedhjen e klubit të vitit janë:
- 7.1.1 Shuma e plasmanit individual dhe ekipor nga pika 4.1.1 deri në pikën 4.1.5, të Kriterëve për zgjedhjen e garuesit më të mirë të vitit,
- 7.1.2 Kryerja e obligimeve statutare ndaj FSHSK-së: 10 poena.

#### **E. Kriteret për zgjedhjen e punëtorit më të mirë të vitit**

##### Neni 8

- 8.1 Kriteret për zgjedhjen e punëtorit të vitit janë:
- 8.1.1 Që gjatë vitit kalendarik ka arritur rezultate të veçanta në organizimin dhe sukseset e klubit ose të FSHSK-së,
- 8.1.2 Që ka realizuar Projekte të rëndësishme në klub ose në FSHSK.
- 8.1.3 Që me punën e vetë gjatë vitit kalendarik ka rritë prestigjin e sportit të shenjëtarisë në organet shtetërore dhe në organizatat tjera të vendit dhe ndërkombëtare.
- 8.1.4 Që ka kontribuar në mirëqenien materiale dhe organizative të klubit ose të FSHSK-së,
- 8.1.5 Që në një mënyrë ka kontribuar në ndërkombëtarizimin e sportit të shenjëtarisë.

#### **IV. DISPOZITAT KALIMTARE**

##### Neni 9

- 9.1 Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, pushon të vlejë Rregullorja mbi mënyrën e zgjedhjes së shenjëtarit-ës, trajnerit, referit, klubit dhe punëtorit më të mirë të vitit, e aprovuar më 11.01.2011.
- 9.2 Kjo Rregullore hynë në fuqi ditën e aprovimit dhe zbatohet deri në ndryshimin dhe plotësimin e sajë nga Këshilli drejtues I FSHSK-së.

Prishtinë 11.11.2022

Kryetari i FSHSK-së

Gëzim Hazrolli

